

UDHËZIM
Nr. 19, datë 22.5.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1917, DATË 1.9.2014
“PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR KALIMIN ME AVION TË
KUFIRIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 1917, datë 1.9.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 3, bëhen këto ndryshime:

- Shkronja “b” ndryshon me këtë përmbajtje:

“b) Të llogarisë shumën e tarifës kombëtare që duhet të paguhet në buxhetin e shtetit për çdo shoqëri ajrore, mbështetur në dokumentin e udhëtimit të pasagjerëve dhe në përputhje me vlerën e biletave të shitura, sipas pikës 1 të këtij udhëzimi.”.

- Shkronja “c” ndryshon me këtë përmbajtje:

“c) Për zbatimin e paragrafit “b” të kësaj pike, TLA-ja detyrohet të rakordojë dhe të faturojë brenda datës 5 të muajit pasardhës me secilën nga shoqëritë ajrore, tarifën 10 euro/pasagjer për kalimin me avion të RSH-së, për muajin paraardhës bazuar në dokumentin e udhëtimit të pasagjerëve për muajin paraardhës (biletën e udhëtimit).

TLA-ja mban aktin e rakordimit me secilën shoqëri ajrore ku evidentohet numri i pasagjerëve që kanë kaluar kufirin, numri dhe vlera e biletave të udhëtimit dhe llogaritjet për vlerën përkatëse të tarifës kombëtare që secila shoqëri ajrore detyrohet t’i paguajë TLA-s si agent, person përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në buxhetin e shtetit të kësaj të ardhure prej tarifës. Rakordimi do të merret i mirëgenë dhe do të konsiderohet i bërë me lëshimin e faturës nga TLA-ja për shoqëritë ajrore. Arktrakordimi i mbajtur dhe fatura e lëshuar nga TLA-ja për shoqëritë ajrore, përmban detyrimin e tarifës për të cilin TLA-ja si agent është përgjegjës të llogarisë, të arkëtojë dhe të paguajë (të transferojë) në buxhetin e shtetit.

- Shkronja “d” ndryshon me këtë përmbajtje:

“d) Faturimet përpunohen mbi bazën e dokumentit të udhëtimit (biletave të udhëtimit) të pasagjerëve dhe këto dokumente arshivohen dhe janë në ruajtje nga TLA-ja.”.

- Shkronja “e” ndryshon me këtë përmbajtje:

“e) Shoqëritë ajrore brenda datës 10 të të njëjtit muaj, paguajnë detyrimin për shumën e tarifës për t’u paguar sipas faturës dhe aktit të rakordimit me TLA-në, në llogarinë bankare të hapur për këtë qëllim nga TLA-ja, e cila e transferon atë në buxhetin e shtetit brenda datës 15 të muajit.”.

- Shkronja “g” riemërtohet “f” dhe ndryshon me këtë përmbajtje:

f) TLA-ja detyrohet të deklarojë dhe të transferojë, në llogarinë e drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar, brenda datës 15 të të njëjtit muaj për muajin paraardhës shumat e faturuara për shoqëritë ajrore, sipas “Formularit të deklarimit të tarifave kombëtare”, bashkëlidhur udhëzimit nr. 26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”.

- Shkronjat “f” dhe “h” shfuqizohen.

2. Në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi 1, pika 4, ndryshon me këtë përmbajtje:

“Shoqëritë ajrore, të cilat kanë përgjegjësinë që të arkëtojnë prej pasagjerëve nëpërmjet shitjes së biletës tarifën e kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë dhe të transferojnë shumat e arkëtuara në llogarinë bankare të hapur për këtë qëllim nga TLA-ja, ngarkohen me detyrat e mëposhtme:”

- Në shkronjën “b”, në fund të fjalisë, shtohet togfjalëshi: “...si pjesë e çmimit të biletës.”

- Shkronja “c” ndryshon me këtë përmbajtje:

“c) Të rakordojnë me TLA-në për tarifën e faturuar për muajin paraardhës, brenda datës 5 të muajit pasardhës dhe të transferojnë për llogari të TLA-së shumat e faturuara, brenda datës 10 të muajit.”

3. Në pikën 6, togfjalëshi “...tarifave që ka arkëtuar...”, zëvendësohet me togfjalëshin, “...tarifave që ka faturuar...”, dhe togfjalëshi “...95% të shumës së arkëtuar”, zëvendësohet me togfjalëshin “...95% të shumës së faturuar.”.

4. Pika 7 ndryshon me këtë përmbajtje:

“Për mosrespektim nga TLA-ja të detyrimeve të përcaktuara në pikën 3 të këtij udhëzimi, zbatohen sanksionet e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 10 të ligjit nr. 9985, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, si dhe të udhëzimeve në zbatim të tyre.”

5. Paragrafi 8, me përmbajtjen “Për mosrespektim, nga degët e shoqërive të huaja ajrore në Shqipëri, si dhe nga shoqëritë ajrore vendëse, të detyrimeve të përcaktuara në dispozitën 4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, për këto subjekte, zbatohen sanksione në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Anila Denaj

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Belinda Balluku